



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj. 16941/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupime pjesmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Isak Rakovica nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik, e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 30.09.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Isak Avdullah Rakovica, i lindur më 1969 në fsh. Bellopije/Podujeve, tani jeton në Rr. Kadri Zeka pn. ne Prishtine, i martuar baba i dy femijeve, Anetare i Bordit ne Kompanine per Menagjimin e Deponive te Kosoves, i gjendjes mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse më 22.03.2010 si Anetare i Bordit ne Kompanine per Menagjimin e Deponive te Kosovë, ka pranuar formularin per Deklarimin e Pasurise dhe kete formular nuk ja ka derguar Agjencionit Antikorrupsion.

Me cka ka kryer kundërvajtje nga 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik.

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 500 (pesqinde) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqsore KGJK-se nr. 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 33 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqsor i pandehuri është i obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kunder Korrupsionit në Prishtinë, parashtroj kërkesën nr. 01/2274/10 të dt.08.06.2010, për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurit dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me Aktvendimin e dt. 19.08.2010 Gjykata per Kundervajjte ne Prishtine ka shpallur fajtor te pandehurin Isak Rakoviaca dhe ka denuar me gjobe prej 500 (pesqind) euro, konform dispoziave ligjore te nenit 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik.

Kunder ketij Aktvndimi pala e paknaqur brenda afatit ligjir ka parashtruar ankese me te cilen ka theksuar se Agjencioni Kunder Korrupsionit në Prishtinë nuk e ka njoftuar me shkrim ndermarrjen NPK Hortikultura” ne Prishtine ne lidhje me obligimin e zyrtareve te kesaj ndermarrje.

Me Aktvendimin e Gjykates se Larte per Kundervajjte ne Prishtine nr. Gjl. nr.1143/2010 te dt. 21.10.2010, ka miratuar ankesen si te bazuar me te cilin Vendim ceket se i pandehuri ka qene i obliguar te beje dekalrimin e Pasurise dhe te Dhuratave si Anetare i Bordit te Kompanise per Menagjimin e deponive te Kosoves, e nuk ka qen i obliguar te kryej te obligim si kryeshef ekzekutiv ne ndermarrjen NPK Hortikultura”. Poashtu me kete vendim eshte cekur se dispozitivi i Aktvendimit te atakuar i shkalles se pare, eshte i paqarte dhe konfuz, ngase aty eshte precizuar data perfundimtare e kur i pandehur ka qene i obliguar te dorezoj formularin e plotesuar per deklarimin e pasurise, e nuk eshte vertetuar se kur e ka pranur kete formulare. Me Verejtjen e Aktvendimit te Gjykates se Larte per Kundervajjte ne Prishtine nr. Gjl. nr.1143/2010 te dt. 21.10.2010 Gjykata per kundervajjte ne Prishtine ndryshoi Vendimin e dt. 19.08.2010 dhe ne proceduren e paraprake qarteso i pandehuri me dt. 22.03.2010 e kishte pranuar formularin per plotesim mbi Deklarimin e Pasurise dhe Dhuratave si Anetare i Bordit te Kompanise per Menagjimin e deponive te Kosoves.

Në bazë të të dhënave të parashtruara në kërkesë, ndëgjimit të të pandehurit, deshmitarit-Zyrtarit të Agjencioni Kunder Korrupsionot, Aktvendimit të GJL nr. 1143/2010, shqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka e shpalli fajtor dhe e gjobiti me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryetjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme. Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrorjë ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

Gjyqtari
Lindita Jakupi

